

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME DRITA KADRIUN

Mitrovicë | Data: 19 nëntor, 2024

Kohëzgjatja: 65 minuta

Të pranishëm:

- Drita Kadriu (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Adea Batusha (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Dritë falemnderit shumë që na keni pranë sot e që keni pranë me bo intervistën. Kisha dasht me ju ndëgju ni prezantim të shkurtër për veten fillimisht, prej çfarë familje jeni?

Drita Kadriu: Falemnderës shumë për këtë mundësi e vlerësoj mundësinë se ne tradicionalisht nuk po arrijmë me shkru kujtimet dhe historinë tonë, ndaj ky rast është i bukur që Kosovës t'ia lëmë një trashëgimi sado e vogël po besoj vlerë do të ketë për shoqërinë në të ardhmen. Përndryshe unë jam Drita Kadriu, jam nga Mitrovica, prindërit e mi Sadik dhe Tahire Kadriu, janë martu në Mitrovicë. Ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore, gjyshi, baba i babës ka ardh në Mitrovicë nga fshati Syrganë dhe ka vazhdu jetën këtu në kushte dhe vështirësina bukur të mëdha.

Hërë pas here duke u kthi në fshat dhe duke provu me jetu mes dy mundësive fshatit dhe qytetit. Në vitet '50-ta prindët e mi janë martu dhe kanë ndërtu familje në Mitrovicë, familjen e tyre. Kanë pas, kanë lindë në të vërtetë dy djem dhe tri vajza. Të gjithë jetojmë dhe veprojmë në Mitrovicë, të gjithë kanë kriju familje të tyre, fëmijtë e prindërve të mi. Janë mirë dhe fatbardhësisht edhe ne po e gëzojmë lirinë falë kontributit të madh të patriotëve tonë dhe së fundi edhe luftës çlirimtare të Kosovës.

Anita Susuri: A mundeni me më tregu si ka qenë në fëmijërinë e juj Mitrovica, si ka qenë shkollimi, krejt kjo periudhë domethonë?

Drita Kadriu: Po unë jam me fat sepse jetoj mes dy shekujve edhe kam pas mundësinë me pa Mitrovicën në rrethana politike të hovshme të zhvillimit të viteve të '70-ta. Kur pas vuajtjeve të mëdha të kombit nën regjimin e Rankoviqit patriotët dhe njerëzit e ditur kanë mrrë që ta realizojnë kushtetutën e njohur si Kushtetuta e '74. Me ç'rast trendet e zhvillimit të kombit tonë janë rritë dhe unë zakonisht kur mendoj dhe reflektoj për këtë histori jam e bindur se këto trende të zhvillimit kanë qenë ngushtë të lidhura me historinë e arsimit të kombit.

Sa më shumë që është rritë pozita politike e kombit tonë aq më shumë është shtri arsimimi. Gjithashtu sa më shumë që është shtrirë arsimimi i kombit aq më shumë është rritë pozita politike deri sot që e përjetojmë dhe e gëzojmë shtetin e pavarur e sovran të Republikës së Kosovës. Andaj sa herë mendoj

për fëmijërinë time që e konsideroj një fëmijëri relativisht të lumtur, rritur në një lagje ku numri i fëmijëve ka qenë ndoshta rreth 50. Ku nuk kemi pas mundësi me qenë në çerdhe të shtetit. Por loja jonë e madhe ka qenë në rrugë, në lagje me fqinjët tanë.

Edhe nuk mbaj mend se kemi pas ndonjëherë raporte të këqija ose ngatërresa të fëmive ose... Lojërat tona kanë qenë të bukura, kanë qenë lojëra me gurë, lojëra me kukulla druri. E kam një tregim me kukulla druri, si i kanë maru tezet edhe gjyshet tona ato kukulla. Kanë qenë loja me llastik, domethonë lojëra që kanë përfshi number të madh të fëmive. Po ne asniherë s'kemi bo konflikt. Në të kundërtën sa herë reflektoj më kujtohen në fund të rrugës sonë kanë qenë banorët, komuniteti sërb, numri i fëmijëve të tyre ka qenë shumë i vogël, por ata kanë qenë të gjithë të përfshim në çerdhe.

Ne nuk kemi pas mundësi ndonjëherë me luft bashkë, sepse mënyra se si ata ju kanë qasë edukimit në raport me ne ka dallu. Ata nashta i kanë përfshi fëmijtë në çerdhe po mas dite ma shumë janë marr me familjet e veta, ndërsa ne nuk kemi pasur ndonjë kufizim për të luajtur në rrugë si fëmi. Gjithashtu më kujtohet si sot, më kujtohet mënyra se si ka funksionu shkolla ku une e kam vijë mësimin edhe jam shumë e lumtur që e kam atë ndjesi të angazhimit maksimal të mësimdhënësve në të gjitha aktivitetet, përveç orëve të mësimi ne kemi pas shumë aktivitete që sot ju thonë ekstra kurrikulare.

Pedagogjia i njeh këto aktivitete pavarësisht nocioneve që sot i përdorim. Dita jonë në shkollë ka qenë gati me thonë gjithë ditën, ke shku në gara të historisë, ke shku në grupin e korit, në grupin e valltarëve, në grupin e shkencave, matematicientëve, shkencave tjera të natyrës, sporteve, varësisht se ku ka pas talent fëmija. Krejt këtë gjendje aq pozitive dhe me trende zhvillimore unë ja kontriboj kontributit të madh të patriotëve të Kosovës por edhe të Mitrovicës që e kanë pa zhvillimin e shoqërisë tonë përmes zhvillimit të arsimit.

Dëshiroj me juve që jeni brez i ri ta ndaj mendimin tim se asnjë rrethanë politike në Kosovën e ish Jugosllavisë nuk i ka fal asgjë Kosovës. Të jem të kuartë këtu në koncepte politike edhe socio-ekonomike të gjitha i kem fitu me mundim shumë të madh vet kombi jonë. Pas Luftës së Dytë Botërore qoftë përpjekje për të drejtën e flamurit, qoftë për të drejtën e universitetit, qoftë përpjekje për Kushtetutën e vitit 1974, domethonë janë rezultat i angazhimit politik e kombëtarë të kombit tonë, nuk janë dhurat nga asni pushtet, prandaj kur e shoh veten si fëmi, e di se kam qenë fëmijë bashkë me fqinjët. Diku 50 fëmijë kemi qenë në lagje, kemi qenë fëmijë jashtëzakonisht të lumtur dhe me tendencë të zhvillimit edhe të përkrahjes.

[Këtu ndërprehet intervista]

Dua me nda me juve, unë kur i kam pas gjashtë vjet, kam shku për herë të parë në kinemanë e qytetit edhe e kam pa filmin e Skenderbeut, si sot e mbaj mend atë skenë jashtëzakonisht të bukur edhe shumë, shumë madhështore.

Anita Susuri: A ka pas shumë njerëz, po sigurisht?

Drita Kadriu: Po, kanë qenë nxënës të shkollave mu më ka marr një edukatore fqinje Melihatja ka qenë më ka marr me grupin e fëmijëve të çerdhes vet.

Anita Susuri: Mitrovica ka qenë qytet industrial edhe kur kemi bisedu edhe me minatorët, që thash e kemi pas projektin, aknë tregu që në kohën kur janë marr rrogat prej Trepçës ka gjallëru qyteti edhe ka qenë ni... si ju kujtohet juve kjo gjallëria e qytetit edhe ka ana sociale po edhe kulturore?

Drita Kadriu: Shumë pyetje e bukur sepse gjithmonë më kujtohet që pavarësisht fuqisë ekonomike që e ka pas familja ka qenë në mode, në trend edukimi për kursim. Ne kemi prit për shembull, ose prindërit kanë thënë, “Këtë mujë nuk mundem ty me ti ble këpucat ose pallton ose diçka” e kemi ditë një rradhë edhe e kemi prit muajin tjetër. Domethonë nëse e ke lëshu ujin shumë prindët kanë thënë, “Hej nale se duhet me kursy”. Nëse e ke lonë dritën dhezë të dhomës ka thonë, “Fike se nuk osht hotel”.

Domethonë trendet kanë qenë po them që familjet janë zhvillu duke pas mendim besoj idenë që nuk mund të shpenzosh atë që e fiton, që ndoshta kur të vijmë te ditët e sotme, këto koncepte pak po ndryshojnë. Ka pas gjallëri, po kur flasim konceptualisht te kombi jonë ka qenë një ide se një njeri punon edhe i mban dhetë vet. Për dallim nga popujt tjerë që kanë jetu në Mitrovicë, ata kanë punu të gjithë, nuk e kanë pas këtë ide.

A vërtetë te na, qoftë minatorët, qoftë ni punëtor, zyrtar i administratës, qoftë kudo që ka punu për ndërmarrje publike, ka punu prindi, baba kryesisht edhe e ka majt familjen edhe i ka domethonë osht përpjekë me i shkollu, me zhvillu familjen. Rol të madh kanë pas mediat e kohës edhe e kam ni tregim për radion e Kuksit në formimin e njerëzve. Për shembull nona ime e ka përcjellë shumë radio Kuksin, po ka pas ndikim edhe zhvillimi i radio-televizionit të Prishtinës, ka pas ndikim në emancipimin social të përgjithshëm të kombit.

Anita Susuri: Ju edhe gjimnazin e keni përfundu po më doket këtu në Mitrovicë?

Drita Kadriu: Po, në periudhën kur une kam qenë në shkollën e mesme, ka qenë një sistem i aprovuar atëherë nga shteti, edukimi i orientuar edhe dy vite i kemi pas mësim të përgjithshëm, ndërsa pas vitit dytë, vitin e tretë edhe të katërt jemi orientu në profesione që kemi dasht me studiu, unë kam qenë në drejtimin kimi biologji, me dëshirën që të studioj mjekësinë. Mësimin e kemi zhvillu në këto paralele tona, në objektet në Zveçan, ndërsa viti parë edhe i dytë i kanë zhvillu këtu në Mitrovicë. Kjo osht periudha ndoshta e viteve ‘75-6-7 të shkollimit të mesëm si ka qenë e organizuar në Mitrovicë.

Anita Susuri: Ideja ju j ka qenë me studiu mjekësinë, si ka vazhdu pastaj, a osht realizu kjo dëshirë?

Drita Kadriu: Për fat nuk arrita të regjistrohem në mjekësi edhe pse kështu si nxënëse isha me të gjitha pesëshe (buzëqeshë), se ndoshta nuk është mirë me thonë. Po nuk e di, nuk arrita me kalu pragun edhe pse kishim shembuj edhe atëherë që nxënësve me sukses ma të dobët janë regjistru po megjithatë e pashë që nuk... edhe u regjistrova në biologji, në fakultetin e shkencave të natyrës me dëshirë që pas vitit parë të kthehm prapë në mjekësi.

Por kur i fillova studimet u pasionova mas mësimdhënësve si Dervish Rozhaja, Ismet Bajraktari, Ahmet Berisha, Mujë Plakolli, mësimdhënës me të vërtetë të fortë, unë kërkoj ndjesë që s'më luajtohen të gjithë me emër. Esat Dauti e tjerë, e tjerë. Edhe kam vazhdu me studiu biologjinë që shikuar nga kjo perspektivë unë jam shumë e përmbushur me profesionin që e kam pas, që e kam zhvillu. Jam pregadit për mësimdhënës të biologjisë edhe në fund të studimeve e kom marr titullin profesor i biologjisë.

Anita Susuri: A keni qenë në Prishtinë a po?

Drita Kadriu: Po në Prishtinë, në Universitetin e Prishtinës i kam zhvillu edhe i kam përfundu studimet, viti '81 më ka zënë në përfundim të shkollës së mesme dhe ato demonstratat e vitit '81 kanë ndiku bukur shumë që mendimet të analizohen më thellë situata kombëtare edhe pse ishim nxënës ne u bëmë pjesë e demonstratave me qëllimin e fitimit përmes demonstratave të shtetit Republikës së Kosovës, bashkë me brezin edhe gjeneratën nuk jemi nda politikisht nga ato lëvizjet edhe pse shpesh në shkollë e në familje na qortonin se, "Nuk duhet të dilni".

Por si të rinjtë që kanë energji edhe besim të plotë nuk u ndamë nga ato lëvizje. Këtu mund ta përmendi sidomos kanë pas ndikim shokët e klasës e shokët e brezit që kalun në gjimnazin matematikor në Prishtinë, Raif Qelaj, Agroni, ka pas shumë që na kanë informu vazhdimisht se cilat janë problemet shoqërore dhe politike të Kosovës. Jam e lumtur që jam bërë pjesë e lëvizjeve që populli i ka organizu.

Anita Susuri: A mundeni me na përshkru për shembull a ka pasë dhunë gjatë atyre... e dimë që ka pasë po çka keni pa ju gjatë këtyre demonstratave të '81-tës?

Drita Kadriu: Po normalisht se me u kthy ni brez i ri kundër shtetit, hiç nuk është e lehtë edhe veç i riu i përbin, i përballon. Sepse na sa herë jemi dal nëpër protesta shkollën e kemi pas në Zveçan kryesisht osht dasht me u kthy kodrave të Zveçanit në Mitrovicë. Ka pasë njerëz familjarë që na kanë përkrah për shembull popullata në kodrën e minatorëve, na kanë strehu deri sa kanë kalu kontrollat deri sa osh qetësu pak ambienti për me ardhë në pjesën e jugut të qytetit. Po gjithmonë ka pas dhunë, ka pas edhe të vrarë në demonstrata si '81-tën, ashtu edhe në vitin 1989.

Anita Susuri: Si ka pasu pastaj për juve jeta profesionale, thatë që ka qenë viti i fundit '81-ta, jeni punësu pastaj, a po?

Drita Kadriu: Unë kam studiu vitin e parë të studimeve '80-'81, jam punësu në vitin 1989, në rrethana ku veç ka marr hov, ndryshimet, kërkesat për ndryshime të rendit shoqëror, hapur pa u rujt. Dhe kam marr detyrën e arsimtarës së biologjisë në shkollën "Fazli Grajçevci" quhet tash ndërsa atëherë është qujt "29 Nëntori". Dhe në ato rrethana kanë pasu migrimet e mëdha të njerëzve por edhe kuadri i kualifikuar kërkonte punë në qasi rrethana edhe në Kosovë. Unë kam vazhdu punën në shkollën fillore në paralagjen e Mitrovicës në Shipol dhe kam qenë shumë, shumë e lumtur.

Sepse kam fillu aty me mësu ma detalisht pedagogjinë edhe didaktikën. Se ne si student të shkencave të natyrës kemi mësu gjanat po pedagogji edhe didaktikë kemi pas shumë pak orë të ndame kështu që praktikisht me mësimdhënësit që kam pasë përvojë të gjatë aty e kam mësu qasjen mësimdhënie, metodat e punës, të kuptuarit se çfarë, nëpër çfarë rruge kalojnë nxënësit për ta kuptu mësimin, nuk i kisha pas këto informata nga studimet.

Kështu që si mësuese në shkollën "Fazli Grajçevci" në Shipol ishim diku 12-13 mësimdhënës të ri që u pranuan në të njejtin afat dhe bashkë me ta i filluam edhe disa ndryshime lëvizje brenda shkollës. Më kujtohet viti '90-të, '91 në nivel të Kosovës ka qenë një komision i ndryshimit të emrave të shkollave dhe që është udhëhequr nga profesori i kimisë Xhavit Ahmeti. Edhe ne si shkollë vendosëm me ndrru emrin e shkollës nga "29 Nentori".

Unë isha e vetme brenda kolektivit që e propozova emrin "Fazli Grajçevci" sepse e kisha idenë që ne duhet ti ndritim heronjtë e '68-tës si brez. Kështu ky propozim u aprovu në atë komisionin në nivel Kosove dhe jam shumë e lumtur që shkolla edhe sot e mban emrin e patriotit e poetit Fazli Grajçevci i cili ka vdek për flamur nga dhuna në burg dhe pastaj ka vdek prej dhunës që kanë ushtru për poezitë e tij dhe patriotizmin e tij.

Anita Susuri: Në vitin '89 tash nuk po e di kur jeni punësu ju, po ka qenë edhe greva e minatorëve, Mitrovica ka qenë kogja në sy të mediave dhe pushtetit në atë kohë. Si e kujtoni ju atë periudhë?

Drita Kadriu: Po në atë periudhë kam qenë disi në mes të Prishtinës, hallës sporteve "1 Tetori" me nejt me shokë e me shoqe, po edhe me pa në Mitrovicë çka po ndodh. Atëherë nuk ka pas edhe shumë transport të shpeshtë. Po megjithatë Mitrovica u bo qendër e të gjitha mediave botërore. Minatorët janë vendosur, gjithmonë i kemi ditë si të tillë por në vitin 1989 ata e treguan edhe një herë veten edhe qëndrimet e veta për ni organizim politik më të favorshëm për shqiptarët. Pavarësisht se nga cili këndvështrim gjykohen historikisht rrethanat.

Unë i adhuroj momentet nëpër të cilat vet kam kalu edhe i kam përjetu ndryshimet shoqërore, ekonomike-sociale. Kështu që me ecë në këmbë siç kanë ecë minatorët Mitrovicë-Prishtinë bashkë me popullin. Normalisht s'ka qenë e lehtë ate e kam përjetu për herën e dytë në luftën e fundit në vitin 1999, na detyruan të ecim në këmbë nga Mitrovica deri kufinin e Shqipërisë nga Gjakova. Po du me

thonë që me jetu në mes dy shekujve është fat. Unë e kam pas këtë fat me njoft njerëz që mu më kanë mësu, më kanë arsimu, mësimdhënësit e mi.

Me i pa strukturat e ndryshme qeverisëse që kanë marr vendime të ndryshme pavarësisht rrethanave ose kërcënimeve si një Selvie Gjinaj për shembull, një grua shumë e zonja e Mitrovicës. Me i pa transformimet shoqërore gjithashtu. Edhe kjo ndoshta osht fat me jetu mes dy shekujve me i njoft njerëzit që kanë kontribuar të kanë pregadit për jetë po edhe tash me pa brezin e ri se çfarë unë mund të bëj për brezin e ri. Si mund t'i orientoj ata. Ju them shpesh nxënësve kur dal me i vizitu, "I keni 15 vjet edhe 50 vjet nuk dilni në pension, mendoni Kosovën si ka me qenë në vitin 2080, imagjinojeni. Sigurisht ka me qenë shumë ndryshe". E prandaj kjo jeta mes dy shekujve i bën njerëzit pak të veçantë.

[Këtu ndërprehet intervista]

Drita Kadriu: Qëndrimet politike të strukturave udhëheqëse shqiptare se mo veç është themelimi Lëvizja Demokratike e Kosovës, LDK-ja dhe ka pas një strukturë qeverisëse viteve të '90-ta, '91-'91. Qëndrimet e tyre kanë qenë që të mos hihet në objekte të shkollave me dhunë, për shkak se mund të dëmtohen, të gjuhet me armë zjarri nga policia serbe në nxanës. Megjithatë në shkollën ku unë punoja si mësuese nuk e kemi pasur këtë problem për shkak se shkolla ka qenë e popullume me fëmijë shqiptarë dhe i ka pas dy objekte.

Njëri objekt më i vogël e kanë shfrytëzuar nxënësit edhe personeli arsimor i komunitetit serb. Kështu që, ne e kemi vazhdu mësimin në të njëjtin objekt në shkollë. Por në vitin 1993, strukturat qeverisëse edhe ish arsimtari Murteza Berisha i cili e udhëheqte lëvizjen e arsimit në Mitrovicë ma rekomandoj që të bëhem drejtoreshë shkolle. Dhe ato rrethana kanë qenë jashtëzakonisht sfiduese po edhe është dasht me pas një guxim. Udhëheqja duhet me qenë gjithmonë edhe e guximshme. Po edhe në qato rrethana është dasht me pa çka mund të bëj një drejtor shkolle kur rrogat janë nal.

Fillimisht janë nal për mësimdhënësit e gjuhës shqipe, mësimdhënësit e artit figurativ edhe mësimdhënësit e historisë e muzikës. Pastaj organizimi i jonë i pavarur ka qenë që të gjitha pagat që janë marr janë ndarë në mënyrë lineare edhe me mësimdhënësit e këtyre lëndëve. Dhe filloj organizimi i strukturave të ndara arsimore. Më kujtohet e kemi shti atëherë lëndën Edukatë Qytetare dhe ka qenë shumë risi për kohën.

Adea Batusha: Çfarë viti ka ndodh?

Drita Kadriu: Po viti '92-3. Unë në vitin '93-'94, vitin shkollor '93-'94 jam bërë drejtoreshë në shkollën atëherë është qujt "Meto Bajraktari" në Mitrovicë. Kam punu si mësuese në shkollën në Shipol mandej jam bo drejtoreshë aty. Falë si me thonë besimit edhe pse nuk ka qenë atëherë të rinjtë me qenë drejtor, po ishin do rrethana të krijuara në këtë shkollë, bukur të fshtira. Konceptualisht edhe politikisht ishin grupu njerëzit në tabore të ndryshme edhe ne si shqiptarë kishim vendos që me i shty

proceset të ndara nga sistemi i Jugosllavisë sepse filloj segregacioni. Ndodhën helmimet e nxënësve, u nalën pagat për mësimdhënësit të gjuhës, historisë, artit figurativ, muzikës dhe nuk mbeti rrugë tjetër, domethonë me u vetorganizu.

Adea Batusha: Këto vitet e para që të ka ra si mësimdhënëse, domethonë '91 ju thatë që keni vazhdu me dhonë mësim në shkollë, s'kanë ardh në asni moment me ju nxjerrë prej objektit shkollor?

Drita Kadriu: Jo, në shkollën tonë jo.

Adea Batusha: A ka pas presion kështu ën forma tjera?

Drita Kadriu: Ka pas...

Adea Batusha: Qysh u kanë qeky presion i manifestum?

Drita Kadriu: Ka pas presion vazhdimisht sepse herë pas here kanë ardh për shembull në oborr të shkollës me pyet, "Me çfarë plan-programi mësoni? Kush është këtu drejtori?". Ka qenë patriotizëm i formës vet, me thonë, "Nuk është këtu. Jemi në mësim". Po shkollat që kanë qenë me nxënës veç shqiptarë e kanë pas pak ma lehtë se sa shkollat që kanë qenë në qytet dhe i kanë pas te dy komunitetet brenda të njëjtit objekt. Unë kur u zgjodha drejtoreshë në shkollën "Meto Bajraktari" tash e ka emrin shkollë "Musa Hoti", aty kemi vepru në të njëjtin objekt me mësimdhënësit edhe fëmijtë e komunitetit serb.

Por këtu dua me theksu ni kontribut shumë të madh që mësimdhënësit e shkollës dhe prindërit e shkollës e kanë dhënë që të kthehet objekti. Siç ju thash ka qenë një qëndrim politik që mos të hyhet në objekte të shkollave me zor. Organizimin e mësimi kur u mbyllën shkollat filluan mësimdhënësit ta bëjnë nëpër shtëpi. Mësimi e klasëve të ulta i merrnin nxënësit në shtëpi të vet, po mësimi e klasëve të larta, gjashtë - nëntë edhe shkollat e mesme filluan organizimin nëpër shtëpitë-shkollë, që ishte shumë vështirë edhe kjo gjendje diku gjashtë-shtatë muaj që ka zgjat.

U thy me vendimin edhe qëndrimin e mësimdhënësit të shkollës "Meto Bajraktari" të cilët në shtator vendosën me i thy barrierat e policisë serbe tre rradhë edhe me hy me nxënës në objektin e shkollës. Edhe kështu ka ndodhë, ata mësimdhënësit kanë qenë heronj të kohës. Përderisa në njërin anë ishte një qëndrim politik shqiptarë që mos të provohet të hyhet në objekte, në anën tjetër tre rradhë me police e kishin rrethu shkollën për mos me hy fëmija shqiptarë, mësimdhënësit bashkë me prindë në oborrin e shkollës kanë vendos me i thy ato rrethoja të policisë edhe me hy.

Më kujtohet shumë mirë Fehmije Lushta mësimja e ka pas klasën të parën ni atë vit edhe ajo e para ja ka mësy derës së shkollës. Edhe këtë praktikë mandej e nisën shkollat edhe të Mitrovicës po edhe anë e kënd Kosovës. Filluan aty ku ka mundësi me i marr objektet. Ky fat nuk i përcolli shkollat e mesme, po

në shkollat fillore kështu ndodhi. Pastaj unë kur u zgjedha drejtor në ndërrimin e paraditës, kanë mësuar nxënës të komunitetit serb edhe arsimtarët, ata kanë pas numër të vogël të nxënësve 300 nxënës nuk i kanë pas, ndërsa e kanë shfrytëzuar objektin e shkollës deri në ora 12.

Ne kemi qenë 1200 nxënës në shkollën tonë edhe e kemi nda prej orës 12:30 deri në ora gjashtë mbrëmje e kemi nda ndërrimin tonë në dy ndërrime. Klasët e ulta kanë punu deri në ora dy edhe në ora dy kanë ardh klasët prej të pestës deri në klasën e tretë. Orët mësimore kanë qenë të shkurta me i pas 35 jemi gëzuar, po zakonisht kanë qenë 30 minuta. Po mësimi, organizimi ka qenë i mirë. Për shembull kur kemi shënu festa, ne i kemi qit e kemi zbukuru shkollën me flamuj, me ekspozita të nxënësve, kemi këndu e kemi majt program. Por sa është bërë ora gjashtë osht dasht me i mbledh ato prej... me i qit në një vend të sigurtë që nesër në ndërrimin tonë nxënësit tonë me i pa se jemi tu festu Festën e Flamurit ose pavarësisë së Shqipërisë ose cilado festë që ka qenë.

Adea Batusha: Deri kur je konë drejtoreshë masnej në qat' shkollë?

Drita Kadriu: Unë kam qenë drejtoreshë aty deri në vitin 2004. Po.

Adea Batusha: 2004, domethonë ty krejt sistemi paralel të ka përcjellë në qat shkollë?

Drita Kadriu: Po, deri në vitin 2004 kam qenë aty drejtoreshë edhe nëse ndonjëherë kam mësuar diçka, kam mësuar prej mësimeve të asaj shkolle që i çmoj shumë, një numër i tyre edhe kanë vdekur tash. Ka pas mësimeve veteranë të Elbasanit. Ka pas mësimeve që kanë ardh me praktika pedagogjike shumë të pasura edhe me të vërtetë kam mësuar prej tyre shumë, shumë gjana.

Pjesa e Dytë

Adea Batusha: A të ka ra hiç me konë në këtë pjesën e shtëpive shkolla se the nja gjashtë-shtatë muj domethonë ju ka ra mu...

Drita Kadriu: Në këtë periudhën unë kam qenë në shkollën e Shipolit si mësimeve dhe në shkollat periferike ku komuniteti ka qenë i pastër shqiptar aty nuk ka pasë probleme, po shkolla në të cilën unë jam bo drejtor ata kanë fillu organizimin nëpër shtëpi, mirëpo tu e pa të pamundur këtë organizim, ata kanë vendos me hy në objektin e shkollës.

Adea Batusha: Domethonë s'jeni kthi mo hiç nëpër shpija, prej atëherë?

Drita Kadriu: Jo. Mirëpo, këtë model me hy në objekte të shkollave e kanë përcjellë mandej krejt shkollat e Mitrovicës, po edhe shkollat tjera nëpër Kosovë, aty ku ka pas mundësi edhe i kemi nda ndërrimet me nxënës serbë. Po nuk është që kemi pas shumë telashe, është dasht me kujdes të madh

me punu deri në vitin 1997 kur veç del në dritë Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Dhe ne e kishim një arsimtar të kthyer nga Gjermania në vitin 1996 i cili kur festonim diçka na thoshte, “Unë kam ardh me u bo ushtar”. Edhe shumë njerëz nuk e besonin, nuk e dinin se po vijnë ato ditë. Kemi marr shumë fëmijë refugjatë në shkollën tonë e kemi diku një listë që ju kemi nda fletore e libra domethonë të atij viti.

E konsideroj shumë historike se s’kemi shumë fakte materiale, ka qenë fshtirë domethonë me u kthy mramjeve në ora gjashtë në periudhat e dimrit, me u kthy nxansit prej shkolle në shtëpi. Po prindërit kanë qenë të mobilizun, i çmoj shumë prindërit e lagjës Bajr, ku ka gravitu shkolla jonë. Na kanë përkrah shumë. Për shembull na nuk kemi pasë poça, prej katërve të ka zonë terri, kanë pru pako me poça i kemi ndërru poçat vet. Kanë pru tesha për shembull të reja, për festa, për Bajram, për vit të ri. Tesha ëpr fëmijë, i kemi nda. Kanë pru fletore, krejt me prindë. Ndër prindë të organizuar jashtëzakonisht mirë kanë qenë prindët e shkollës ku unë kam punu si drejtoreshë.

Anita Susuri: A keni pas rast që ka ardh policia ju ka marr në inspektorat ose në pyetje?

Drita Kadriu: Shkolla “Meto Bajraktari” ka qenë përball kazermës ushtarake, ata kanë ardh shumë shpesh sepse fëmija në pushime i kanë çelë dritaret, kanë këndu. Ka qenë ngritja e dy gishtërinjëve, ka qenë gati si vepër kriminale ose si me thonë. Kanë ardh janë anku edhe struktura ushtarake edhe policore. Po ne kemi qëndru aty stoikisht se me të vërtetë ka qenë e vështirë, për çdo lëvizje të fëmijëve ata kanë ardhë në shkollë. Po arsimtarët, mësimmhënësit, kujdestarët e ditës, kujdestarët e nxënësve nuk kanë leju, si me thonë, ni fëmi me u maltretu e keni parasysh që kanë qenë mësimmhënës që kanë vepru me vite e vite në qytetin e Mitrovicës.

Kanë qenë të mirënjohur ndoshta edhe policinë i kanë pas nxanës të shkollën në faza të ndryshme. Po kanë qenë shumë stoik me i rujt fëmijtë edhe me e rujt shkollën. Jam shumë e lumtur që kurrë nuk kemi pas frikë. Ndoshta tash kur mendoj them, “Si ka qenë e mundur ajo?”. (Qeshë) ndoshta psikolog duhet me na studiu ose si ka qenë e mundur ashtu me u mobilizu organizmi edhe ti me u ballafaqu. Për shembull kolegja ime ka qenë drejtoreshë grua gjithashtu e paraleleve serbe.

Në një periudhë kur fëmija e jetimorës Mitrovicës janë largu prej jetimorës dhe janë shpërnda kudo që është histori në veti ajo nëse ka dikush që mundet me i grumbullu ato të dhana. Kishte fjet një natë një fëmijë në shkollë, në klasë. Edhe kur vijnë pastrusët herët sërbe me i pastru paralelet, klasët e tyne, i kemi aps edhe klasët e ndame kush çka pastron e kanë gjet fjetun në banka. Po aq shumë ka pas telashe me atë fëmi e aq është dasht me mbrojt e me rujt e. Hiç nuk e di sot ku osht. Osht dasht me rujt po për fat edhe mësimmhënësit e kanë ditë mirë gjuhën sërbe edhe kanë qenë këmbëngulës.

Për shembull arsimtarja Fatime Xhaka e cila është vra bashkë me bashkëshortin në vitin 1999. Edhe gjithashtu është vra arsimtari i artit Murat Emini bashkë me djalin e vetëm që e ka. Domethonë ka qenë një strukturë e mësimmhënësve që saktë e kanë ditë kah jemi tu shku na si popull edhe kanë qëndru. Kemi qëndru. Unë gjithmonë e kujtoj me dashuri të madhe, sa herë kemi festu 28 Nëntorin

arsimtari Murat thoshte, “Shumë shpejt ka mu bo shumë mirë në Kosovë. E kam ni dëshirë shumë të madhe niherë me shku te liqeni Shkodrës me hongër peshk e me pi ni gotë raki”.

Ose arsimtarja Fatime thoshte, “Po çka, ka mu bo shumë mirë! S’kemi me pas vend ku me i parku kerret, veturat”. E tash kur e shoh prej kësaj perspektive them, o Zot sa vizionar e sa këmbëngulës kemi qenë, kanë qenë njerëzit në përgjithësi populli. Vështirësia ka pas të natyrave të ndryshme. Shumë të ndryshme kanë qenë po nuk na bjen shpesh me fol kështu sikur me juve që po e çmoj shumë (emocionohet).

Adea Batusha: Çka e ka veçu Mitrovicën në aspekt të arsimit? Se përnime folëm edhe ma herët qekjo puna që njerëzit fokusohen ma shumë te Prishtina po e përmene ni sen të rëndësishëm që Mitrovica e ka nisë qeto me u kthi nëpër objekte edhe pak e ka nisë ni trend. Për çka të doket ty që është veçu, që osht e veçantë në arsim paralel?

Drita Kadriu: Unë besoj te njerëzit që i ka pas në udhëheqje siç është arsimtari Murteza Berisha me ekipin e vet. Pastaj me drejtor të shkollave. Drejtorin Pllana e kujtoj, ai është gjallë ende për shembull, plotë, krejt drejtorët. Ishim edhe ni brez i ri i drejtorëve që jemi zgjedhë me i shty proceset tutje. Më kujtohet unë kur kam shku për herë të parë në shkollë si drejtor shkolle, aq shumë kanë pas kundërshtime, “Kush të ka zgjedhë? Kush je ti, na kemi këtu mjaft kuadro me qenë drejtor. Pse ti me ardh prej jashtë?”. Domethonë ka qenë ajo konkurenca të rish siç je apo ti bësh dy hapa ndryshe dhe të lëvizësh drejt vizionit që e kishin vendos patriotët tonë.

Edhe me të vërtetë Mitrovica pse është e veçantë, sepse gjithmonë historikisht sigurisht për shkak të Trepçës dhe industrisë që e ka pas ka tërënjë shumë intelektual. Ka tërënjë shumë kuadra të forta, po që gjithashtu janë cilësu edhe për patriotë. Edhe për patriotë janë cilësu sepse me vepru, besoj unë tash nga kjo perspektivë. Me vepru në një ambient të tillë politik e me qenë korrekt e i drejtë me popullin është dasht me qenë trim. E Mitrovica ka pas të tillë, ka pas të tillë, ka nga të gjitha sferat, arsim, kulturë, sport, industri, ekonomista të fortë, njerëz që kanë jetu edhe nga sektori privat, që komunitetit i kanë ofru mbështetje.

Ne nuk e kemi pas problem me dal në pazar me ble dorëza për punëtorët teknikë se ai në tregu që ka shit dorëza, ai ti ka falë. Thojnë, “Jom ardhë prej shkollës” ka shku me ble dorëza, “Jo për shkollë qe falë”. Mësimdhënësit që kanë udhëtu gjithandej nëpër zona rurale ata nuk kanë pagu bileta autobusi, se ai bartësi ose pronari i kompanisë i ka thonë, “A je arsimtarë a? Jo, ti nuk pagun”. Domethonë kanë qenë kontribute që e kanë majt jetën. Na kanë majt të gjithëve, secili kemi bo diçka të veçantë në mënyrë që me funksionu si një sistem real. Se unë po thom real, tash dikush po na thotë paralel keni qenë. Unë them një sistem real i pavarur si arsimi poashtu edhe shëndetësia, nëse dikush mledh informata njejt ka qenë në Mitrovicë edhe shëndetësia e organizume.

Adea Batusha: E sa je konë e përfshime në organizimin e arsimit, se për qeto s'folëm shumë. Domethonë ti e ke pas punën si drejtoreshë po je konë edhe e përfshime gjonsisht se çka o tu ndodh në Mitrovicë. A jeni mledhë me fol, me diskutu?

Drita Kadriu: Po, sigurisht, ne kemi pas takime të rregullta mujore. Sepse e para që ka qenë tema kryesore ka qenë siguria. Siguria në shkollë si do të sillemi. Nëse ndodh që vjen dikush çka duhet me bo, qysh duhet me u sillë, si duhet me u sillë me nxanës, si dueht me i rujt nxanësit. Ne e kishim një rast tash po më kujtohet, ju që po e përmendni. Kishte një fëmijë gjakderdhje prej kokës e u dasht me çu me emergjencë në spital me arsimtarin e fiskulturës Fatimën. Kur shkojmë atje, mezi shpëtum e u kthym. Ata ndihmën ja dhanë nxansit, ja pastrun plagën, ja qepën kokën e. Mirëpo, menxi u kthym na tu na pyt ata, “Ku e keni UÇK-në, a po ju çoni bukë?”

Se ç'është e vërteta ne çdo të shtune sa herë kishim mundësi mledhshim pak pare e arsimtarja Fatime dilte në treg blente ushqime të qëndrushme si mish terrun, qorapa ose tesha ma të trasha edhe e kishim fëmion e ish arsimtarit tonë Ajetit në shkollë nxënës, ja jepnim atij, “A ki me shku te babi? Merri çoj”. E ata kishin kësi informata ç'a po ndodhë sepse silleshin informatat. Na shkum në spital me dhonë ndihmën e parë menxi shpëtum, domethonë menxi u kthym në shpi. Po unë kam qenë shumë aktive në orientim...

Adea Batusha: Mbledhjet ku i keni majt?

Drita Kadriu: Kryesisht i kemi majt në shkolla, në shkolla, në institucione të ndryshme shkollore. Po në shkollën Avdullah Shabani janë majt shumë takime edhe ka qenë Këshilli i Financimit i vendosun aty. Në atë shkollë janë majt takime shumë edhe në shkollën time. E kemi pas sallën e edukatës fizike kemi mujt me kriju hapsira ma të mëdha, janë majt në shkollën “Migjeni” ku kanë qenë të vendosun Këshilli i Arsimit, domethonë strukturat qeverisëse të arsimit në shkollën “Migjeni” kanë qenë të vendosuna. Domethonë kemi pas lëvizje edhe marrveshje, atëherë s'kemi pas mobila. Po jemi marr vesh, të martën e parë çdo muj shihemi këtu. Domethonë ka pas mekanizma instrumente tjera të ndryshme, të mira për me u organizu.

Anita Susuri: E rastet me helmime i përmendët ma herët, a mundeni me na përshkru rastet konkrete?

Drita Kadriu: Kryesisht ka ndodhur në shkollat e mesme. Nëse arrini me i taku njerëzit e shkollave, mësimdhënës, drejtor të shkollave të mesme, kanë qenë të shkollave të mesme.

Adea Batusha: Shkollat e mesme krejt jonë mshelë në atë kohë?

Drita Kadriu: Po, asnjë prej shkollave të mesme nuk ka majt mësim në objektin e tyre. Po as universiteti, shkolla e lartë, shkolla teknike këto kanë qenë të vendosura në shkollën “Skenderbeu” në lagjen Vaganicë, aty ka qenë ni punkt i madh. Universiteti e ka majt mësimin aty, shkolla fillore, shkolla

teknike se kom punu pak kohë kom ndihmu në organizim të mësimi të landës së biologjisë në shkollën teknike, aty kemi pas orët.

Adea Batusha: Gjatë kohës sa ke qenë drejtoreshë?

Drita Kadriu: Jo gjatë kohës sa kam qenë mësuese. Se dulën arsimtarët jashtë e mbetshin klasët pa mësimdhënës edhe vullnetarisht i kemi majt orët në dy-tri shkolla ku ka pas nevoj se është bë java 40 orë mësimore ose 60 nuk e kemi pas problem.

Anita Susuri: Deri cilin muj kanë vazhdu shkollat, '99-tën besoj?

Drita Kadriu: Po, më kujtohet saktë me 13 mars të vitit 1999, ka qenë ditë e shtune kur ka ra granata në tregun e Mitrovicës, granatat kanë ra edhe të hënën i ka ra 15, po më duket 15 marsi, unë kam hy në shkollë për herën e fundit, në shkollën ku isha drejtoreshë. Edhe kam hy bashkë me pedagogen Mejremen, Fatimen arsimtaren e fiskulturës edhe sekretarin. Dhe kanë ardh. Jemi mundu me marr diçka, prej dokumentacioneve nuk kemi mrri, kanë ardh policia edhe na kanë qit dhunshëm prej shkollës. Mo prej asaj dites nuk jemi kthy deri ka fundi i shtatorit vitit 1999. Për shkak se kur jemi kthy, kur ka përfundu lufta në shkollë ishin aps vendosur trupat e NATO-s dhe kemi zhvillu shumë negociata me UNMIK-un për me na liru objektin e shkollës.

Anita Susuri: Ju thatë që ju kanë detyru me ecë gjatë luftës, osht ai marshi i famshëm i Mitrovicës. Ju kujtohet si ju kanë nxjerrë prej banesës ose shtëpisë, qysh ka ndodhë krejt kjo?

Drita Kadriu: (Buzëqeshë) edhe kjo osht histori në vete se unë jetoj në lagjen Ilirida, ose Tavnik. Mc Kresha i thotë “Tavnik City” (qeshë).

Anita Susuri: Edhe ne e njohim si Tavnik (qeshë).

Drita Kadriu: Me të vërtetë shumë ngjarje historike kanë ndodhë në Tavnik. Artim Jashari e organizime tjera e tjera.

[Këtu ndërprehet intervista]

Drita Kadriu: Atë ditë që na kanë qit prej shtëpijave në mëngjes herët jemi mbledhë fqinjët edhe më kanë porosit mu me shku te stacioni i autobusëve me kqyr a ka qarkullim të njerëzve dhe a ka qarkullim të autobusëve. Jom shku, jo rrugës kryesore se ishte rrezik, po kam dal prej mureve, prej oborreve në oborre edhe ju kam ofru rrugës mrapa stacionit me pa se çka ka. Aty kam pa se stacioni i autobusave osht mush me policë edhe ushtarë serbë. Ne atëherë i thojshim disave që kanë pas dorëza të bardha, i thojshim *bela ruka*, dora e bardhë. Disa kanë pas dorëza të zeza thojshim *crna ruka*, ose dora e zezë. Disa kanë pas kapela shumë të mëdha i thojshim frenkovcat, “Ishin frenkovcat”.

Po atë ditë herët ndoshta ka qenë ora pesë e mëngjesit, katër e gjys, kur i kam pa përball murit ku isha duke vështruar stacionin kanë qenë të gjitha llojet e ushtrisë e policisë serbe në stacion ama plot. Edhe jam kthyer shpejt në shpi ju kam thënë edhe djemve të rrugës edhe familjarëve, nënave, krejt pritshim çka po ndodh se e kishim në ndjesi që atë ditë ka me ndodhë një tragjedi. Ju kanë thënë nuk ka asnjë shans me ju afër stacionit se ish mush me policë e ushtarë. Po sa është bo ora shtatë një plumb ka rambur dritaren e shtëpisë tonë. Kemi qenë në oborr duke e përcjellë njërin prej fqinjëve se më tëmet me një pozitë shumë të vështirë të vendimmarrjes nuk dinim si të vepronim.

Atëherë ka filluar policia me ardhur nëpër shpi me na i çelë dyrt edhe me na thënë, “Dilni, dilni, dilni”. Na kemi dalë atë ditë edhe kemi shkuar në stacionin e autobusave, po ajo ditë nëse diçka më kujton më kujton ato shirat e mëdha të filmave të Vietnamit, aq ka qenë në shi i madh. Dhjetra, mijëra njerëz jemi bo bashkë në stacion të autobusave e kam një tregim edhe për këtë, për këtë ditë veç për këtë ditë. Kanë filluar gjujtjet nga të gjitha anët, po gjithashtu moti me shi, ka pas shumë murmurime e vetëtime edhe shpesh nuk e dinim a janë armët a janë vetëtimat, murmurimat.

Pasi është mbledhur krejt lagja aty kanë ardhur i kanë marrë burrat edhe djemtë. Aty kam pa se për njerëzit pa dallim gjinie shpirti osht i ëmbël. E kom pa në plakë tuja vendos shaminë të birit, edhe më thoshte ngadalë, “E kom të hasretit”. Nuk mundem me përshkruar veten emocionalisht qysh kam qenë. Tu e përcjellë domethonë krejt situatën deri sa kemi dalë prej shtëpisë në rrugë, i kanë marrë agjën me djalë vëllaun. Të gjithë fqinjët tanë i kanë shtirë në një kamionetë të vogël. Po kur jemi bo bashkë në stacion të autobusave atëherë i kanë marrë me skania të gjithë mashkujt edhe i kanë çu.

E kemi kaluar qatë ditë qashtu. Me qenë nën peron të autobusit ka qenë koka në privilegj se s’te ka rrokë shiu po ishte e pamundur. Edhe më kujtohet një fqinje e imja na i thojmë ablla Zarife, e kishte djalë... se i vendosën meshkujt të mbështetun për parrakve të stacionit edhe binte shi i madh kjo e murçadrën me ja çu djalit të vet. Po krejt e pam që po dojnë me ekzekutu, po pa thënë Zoti nuk vdes këkrush. I bërtitën edhe e kthyn. Kemi qëndruar ashtu deri në ora shtatë mramje si është bo ora shtatë fiks, kanë gjujt në ajër me diçka edhe kanë hyrë policia na kanë thënë, “Jeni të lirë shkoni në shpi”.

Na jemi kthyer nëpër shtëpi pas disa ditëve na kanë detyruar me shkruar në dyrtë e shtëpive, me shkruar në gjuhën serbe se, “Ne gjendemi në shtëpi” edhe i kemi shkruar ato, jemi marrë vesh me lagjen, a me i shkruar. Me shkruar se jemi në shtëpi kanë me na gjetë, mos me shkruar ata hyjnë të gjejnë, si me vepruar ish dilemë koka e madhe. Megjithatë krejt si lagje vendosëm me shkruar. Edhe ishte një ditë prej ditëve, një ditë e bukur pranverore, kishin dalë fëmija, se kishim shumë refugjatë në shtëpi. Kishin dalë fëmija në oborr me lujt edhe unë po ju thom, “Ma ngadalë se këqyre janë policia andej”, bile atëherë ju thojshim milicët. “Jonë anej milicia”. Po thanë, “Ti e ke shkruar vet në derë që na jena në shpi” në fëmijë gjashtë vjeç, u befasova.

Na kanë dhonë urdhër me shku me u regjistru në Komunë pas tri-katër ditëve, vishin nëpër shpija, thojke, “Sot ki me shku me u regjistru” kemi ardhë këtu para komunës krejt qashtu me lagje me u regjistru e kam atë kartonin e gjelbërt që na kanë regjistru. Edhe në ndërkohë silleshin ajroplanat e NATO-s ne u regjistronim këtu në qiell të hapur kishin qit tavolina edhe do zyrtarë gjysëm të uniformuar na regjistronin. Sa herë që silleshin ajroplanat e NATO-s ata hynin nër tavolinë (qeshë) e ne u lutshim, “Gjuje një qitu” (qeshë). Se ajo linja mes jetës edhe vdekjes aq e hollë osht nganjëherë në luftë sa nuk të bon asnjë përshtypje edhe me vdekë. Domethonë osht gati krejt njejtë.

E pastaj me 16 maj na kanë qit në rrugë me dal për Shipni me shku, edhe jemi nisë qashtu krejt si lagje, si Tavnik. Ni natë kemi fjetë në lagjen Shipol. Pastaj kemi ecë në kambë qashtu. Shiu gjithë rrugës na ka... se na kanë nda në grupe, në Gjurakovc e kanë nda grupin që ka shku ka Peja edhe grupin që ka shku ka Gjakova. Ne, unë edhe shumë njerëz kemi shku ka Gjakova, na kanë nal, na kanë stacionu në fshatin Gremnik, aty kemi nejt dy javë edhe ajo osht histori tjetër në vete. Se nuk ka pasë, shtëpitë kanë qenë të kallura, nuk ka pasë ushqime, nuk ka pasë... Për shembull pesë kilogram miell i blenim prej vet sërbeve që i shitnin ushtarët sërbe 100 marka. Pesë kilogram 100 marka. Ka qenë shumë fshtirë.

Pastaj, ne mendonim që do të shkojmë për Shipni, na erdhën përsëri, edhe aty besoj shumë ka pas dhunë seksuale, kidnapime dhe vrasje po. Po për dhunë seksuale kështu nuk kam... po e di që kanë hy nëpër shtëpi, qashtu shtëpi të djegta ku kanë qenë njerëzit e strehum, kanë hy. Pastaj na kanë ardh na kanë qit prej atyne shtëpive dhe kanë thonë keni me u kthy për Mitrovicë. Jemi kthy për Mitrovicë, gjithashtu kemi bo dy ditë, ni natë kemi fjetë në fshatin Brojë. Aty nata ka qenë jashtëzakonisht e fshtirë sepse kanë ardh qashtu ushtria sërbe nëpër popull. Se ata vet frigoreshin e mandej hyshin në popull me u strehu pak.

Edhe kur na ka zbardh drita jemi nisë në hyrje të Skenderajit aty kanë marr shumë njerëz, djemë edhe burra. Na kanë lëshu neve, edhe aty domethonë ka qenë një punkt. Kemi vazhdu tutje, në hymje të Mitrovicës, në fshatin Lushtë kanë dal Ushtria Çlirimtare na kanë thonë, “Mos shkoni ka rruga kryesore se po i marrin djemtë edhe burrat, po hyni fshatrave, ni numër i madh i burrave qashtu kanë shpëtu se kanë shku me ushtarë nëpër Lushtë, e kanë dal në Shipol me kalu qat punktin te ujësjellësi që ka qenë shumë i fshtirë. Po edhe aty kanë marr shumë djemë e burra, kanë marr shumë, i kanë burgos. Të cilët ni number i madh i tyne pastaj jane lëshu prej Kryqit të Kuq.

Edhe mandej nuk pat shumë, shumë kohë se marrvëshjet u arritën e fillun pak me u tërhjekë ushtria, policia sërbe. Po jemi kthy diku, ndoshta 30 maj [1999] në Mitrovicë edhe niherë. Po kur jemi kthy prej bombardimeve disa shtëpi kanë qenë të kallura prej sërbeve, disa shtëpi prej atyne bombardimeve që kishin ndodhë në Shalë të Bajgorës, detonime shumë të rana i kishin lëviz dritaret e dyrtë e. Vjedhje kish pas shumë domethonë nga ushtria sërbe, paramilitarët e, është histori në vete me ju tregu paramilitarët gjithë rrugës sa kemi shku për Shqipëri. E që jemi nal në Gremnik, po edhe sa jemi kthy që na kanë shoqnu, qashtu malltretime, fëmi të uritur, pleq e plaka që është dasht me i mbajt djemtë e

vajzat, qoftë në kolica, karroca të ndërtimtarisë, qoftë në shpinë. Domethonë osht histori në veti. Nuk e di a mundet një mendje kreative e artistëve me bo filma sa ma real të tillë.

Anita Susuri: Dhe ju pastaj deri në përfundim të luftës keni qenë në Mitrovicë?

Drita Kadriu: Kemi qenë, kemi qenë në Mitrovicë. Po edhe në ofenzivë me 8 qershor ka qenë bukur e madhe po osht tejkalu falë njerëzve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe aeroplanëve të NATO-s, që na thonin, “Mos hyni në stadionin e Mitrovicës po silluni sepse me hy në stadion ju ndodh si Srebrenica”. Edhe në atëherë sillëshim krejt masa e madhe e njerëzve në lagjen Tavnik city që i thotë Kresha. Edhe kaloj edhe ajo, po mandej u arrit marrëveshja e filloj jeta e re.

Anita Susuri: Pastaj thatë që deri 2004-tën keni qenë drejtoreshë?

Drita Kadriu: Po.

Anita Susuri: Pastaj keni vazhdu si...

Drita Kadriu: Në 2004-tën disi mu duk vetja që jam përmbush me udhëheqjen në shkollë edhe vendosa me lëviz në detyrë. Fillimisht kam punu me KEC-in, në organizatë e Prishtinës në zbatimin e një projekti të Bankës Botërore që shkollat i ka përkrah me grante. Ato i kemi trajnu me pregadit plane zhvillimore, projekt-propozime po edhe kanë marr mjetet prej këtij granti i kanë realizu synimet e veta nëpër shkolla. Unë e kam mbulu këtë regjionin e Mitrovicës, Vushtrri, Mitrovicë, Skenderaj edhe Drenas. Ku mu dha në mundësi shumë e mirë me njoftë shumë mësimdhënës, kolektive, njerëz.

Dhe në vitin 2008, në zgjedhjet e nëntorit të vitit 2007, unë e fitova mandatin për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Mandej kam punu në Kuvend deri në vitin 2010, kur kanë ndodhë përsëri zgjedhjet dhe unë kam kalu me detyrë në Ministrinë e Arsimit, fillimisht këshilltare e lartë politike e ministrit Ramë Buja. Pastaj kam punu si drejtoreshë e Departamentit të Arsimit të Lartë. Në ndërkohë ndohesha e përmbushur profesionalisht dhe zhvillimin akademik, krahas zhvillimit profesional e realizova duke i mbyll studimet e mia në master në udhëheqje arsimore dhe në doktoratë duke i trajtu terminologjinë e re në fjalorin e mësimdhënësve.

Me ç’rast kam botu me një kolege timen nga Tirana një fjalor të fushës së edukimit i cili i ka diku 1 mijë fjalë të reja që kanë hy në fjalorin e mësimdhënësve pas luftës. Ka qenë fshtirë me i përbi disa nocione. Kurrikulë, brainstorming, insert, kllaster, e kështu fjalë të reja. Fjalori i shpjegon fjalët e reja të edukimit, i ka diku 1 mijë fjalë të reja që kanë hy në... Edhe pastaj kam vazhdu me punu si mësimdhënëse në Universitetin e Gjakovës. Edhe në vitin 2022 me ftesën e kryetarit Bedri Hamza, kam marr detyrën e Drejtoreshës së Arsimit në Komunën e Mitrovicës.

Anita Susuri: Ne ju dëshirojmë suksese në të ardhmen edhe ju falemnderit shumë edhe për kontributin e juv edhe për intervistën!